



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

*01 Nr. 02-60/01-16867/21
Kaçanik, 30.06.2021*

**RREGULLORE E BRENDSHME NR. 02/2021
PËR PËRDORIMIN E AUTOMJETEVE ZYRTARE**

Qershor 2021

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12.2 (c) lidhur me nenin 40.2(a) e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 34.5 e Statutit të Komunës së Kaçanikut (teksti i spastruar sipas Statutit 01.Nr.60/01-12895/20 për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.3588/2008 të datës 25/09/2008), Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30 Qershor 2021, Miratoj këtë:

RREGULLORE E BRENDSHME NR. 02/ 2021

PËR PËRDORIMIN E AUTOMJETEVE ZYRTARE

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 **Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e procedurave për përdorim dhe shfrytëzim të rregullt, ekonomik dhe efikas të automjeteve zyrtare në pronësi të Komunës së Kaçanikut.

Neni 2 **Përkufizimet**

Me këtë rregullore, termat e mëposhtëm kanë kuptimin si vijon:

- a) Automjetet zyrtare – automjetet që janë në pronësi, përdorim apo në administrim nga ana e Komunës.
- b) Zyrtar i lartë komunal – Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit Komunal dhe Drejtorët e Drejtorive.
- c) Udhëtim zyrtar – lëvizjet të cilat kanë një destinacion për qëllim të kryerjes së detyrave zyrtare
- d) Njësia e transportit – nënkupton njësinë e cila është e ngarkuar me detyrat e udhëheqjes së transportit, pranë Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme.
- e) Forma e raportimit – Forma unike në përdorim për evidentim të përdorimit të automjeteve zyrtare e cila shërbim si bazë për monitorim dhe raportim mbi përdorimin e automjeteve zyrtare.

Neni 3 **Përdorimi i automjeteve zyrtare**

- 3.1 Kryetari i Komunës ka të drejtë të ketë në përdorim 24 orë automjetin zyrtar, për punë zyrtare.
- 3.2 Të drejtë shfrytëzimi 24 orë mund të kenë zyrtari i lartë ose zyrtari publik në raste të veçanta me vendim të Kryetarit të Komunës.

3.3 Zyrtarët e lartë komunal kanë të drejtë në përdorim të veturave zyrtare për qëllime zyrtare gjatë orarit të punës. Ndërsa vartësit e tyre kanë të drejtë të kërkojnë përdorimin e automjeteve zyrtare për kryerjen e punëve zyrtare.

3.4 Asnjë person nuk mund të përdorë automjetet zyrtare pa patentë shofer të vlefshëm si dhe pa autorizim për ngasjen e veturave zyrtare.

3.5 Autorizimi për përdorimin e veturave zyrtare lëshohet nga njësia e transportit në kuadër të Drejtorisë të Administratës së Përgjithshme, ndërsa për veturat në përdorim nga stafi shëndetësor leja jepet nga njësia përgjegjëse në kuadër të Drejtorisë të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

3.6 Automjete zyrtare mund të përdoren për përdorim zyrtar edhe jashtë vendit.

3.7 Përveç simboleve zyrtare, automjetet zyrtare nuk mund të kenë asnjë simbol apo shenjë tjetër.

3.8 Përdorimi i automjeteve zyrtare duhet të jetë sa më efikas dhe të mënjanohen udhëtimet e zyrtarëve në të njëjtin drejtim me vetura të ndryshme.

3.9 Të gjitha automjetet e komunës, me përjashtim të automjetit zyrtar të Kryetarit të Komunës dhe në raste të veçanta sipas paragrafit 3.2 të nenit 3, pas përfundimit të orarit të punës/udhëtimit duhet të qëndrojnë në parkingjet përkatëse të automjeteve të Komunës.

Neni 4 Evidentimi

4.1 Cdo automjet zyrtar do të ketë formën e cila shërben për raportimin e gjendjes së odometrit në nisje dhe në përfundim të udhëtimit, kohën e nisjes dhe kthimit, datën, numrin e personave në automjet, destinacionin, vozitësit, arsyen e udhëtimit, shënimet në rast të mbushjes me karburant etj.

4.2 Ngasësi i automjetit është i obliguar t'i plotësoj në mënyrë të saktë dhe në kohë të dhënat në formën e raportimit dhe të njëjtën në fund të udhëtimit, apo më së largu të mëngjesin e së nesërme ta dorëzoj tek Njësia e Transportit.

4.3 Çdo zyrtar publik i cili merr veturën në shfrytëzim, obligohet që të kontrolloj gjendjen e veturës para se të udhëtoj si dhe të njëjtën ta kthejë po në atë gjendje.

4.4 Njësia e transportit është e obliguar që shënimet nga forma e raportimit t'i bartë në formë elektronike në mënyrë që të krijohet një bazë e qartë dhe e saktë raportimi dhe krahasimi e cila do t'i shërbente vendimarrjes së menaxhmentit dhe do të linte gjurmë auditimi.

4.5 Format për qëllime raportimi janë pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 5 Mirëmbajtja dhe servisimi

5.1 Në ditën e parë të punës të secilës javë, por pa u kufizuar në ditë, njësia e transportit kontrollon:

- niveli i ujit të ftohjes;
- niveli i vajit për frenim;
- fushat në tabelën e të dhënave në veçanti nivelin e karburantit;
- dritat e përparme, të pasme si dhe treguesit;
- pajisjet për ndreqjen e defekteve dhe mjeteve shtesë;
- tabelën e kilometrave për servisimin e ardhshëm;
- gomat, rrjedhjet e mundshme të vajit, ujit dhe tjera;
- pastërtinë.

5.2 Përgjegjës për riparimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare është njësia e transportit pranë Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme.

5.3 Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve bëhet vetëm me operatorin ekonomik të zgjedhur nga komuna. Përjashtim bëjnë rastet e kur veturat kanë mbulesë garancioni nga prodhuesi apo në rast se intervenimi është i pamundur për shkak të distancës ose rrethanave tjera të jashtëzakonshme.

5.4 Para dërgimit të automjetit zyrtar në servisim, duhet plotësuar formulari në të cilën shënohen të dhënat e automjetit, arsyea e dërgimit të automjetit në servisim dhe defektet e paraqitura në automjet. Kjo përgatitet në dy kopje, një për njësinë e transportit dhe një dërgohet në servis.

5.5 Njësia e transportit duhet të jetë vigjilent se cilat nga servisimet mund të përfshihen në ndonjë garancion të veturave.

5.6 Njësia e transportit është përgjegjës që të mbaj të informuar menaxhmentin për ekonomikitetin e automjeteve në mënyrë që të mirren vendime se cilat nga automjetet mund të hiqen nga qarkullimi.

5.7 Të gjithë drejtuesit e automjeteve janë përgjegjës për kujdes të shtuar në vozitje, respektimin strikt të rregullave në komunikacion, të dhënit përparësi këmbësorve.

Neni 6

Aksidentet, gjokat dhe dëmtimet

6.1 Në rastet kur një automjet është i përfshirë në aksident, drejtuesi i tij ndalë automjetin dhe qëndron në vendin e aksidentit deri në mbërritjen e autoriteteve policore. Njëkohësisht njofton njësinë e transportit dhe kompaninë e sigurimeve.

6.2 Në rast të vetaksidentit, gërvishtjeve apo dëmtimeve tjera, drejtuesi njofton njësinë e transportit dhe konsutohet për hapat që duhet ndërmarrë.

6.3 Në rast se raporti i policisë dëshmon se dëmtimet në veturë janë shkaktuar si pasojë e moskujdesit gjatë ngasjes të zyrtarit publik, atëherë nga Drejtoria e Administratës inicohet procedurë disiplinore ndaj atij zyrtari.

6.4 Në rast të sjelljeve të pahijshme të zyrtarit publik gjatë ngasjes në komunikacion, atij zyrtari do t'i ndalohet të ngasë veturë zyrtare për 1(një) vit.

6.5 Në rast të gjobave, përgjegjësia për pagesë i takon drejtuesit të automjetit, përveç gjobave për parkim dhe atë nëse arsyetohet mjaftueshëm që gjoba nuk ishte si pasojë e moskujdesit të mjaftueshëm në parkim.

Neni 7

Përdorimi i automjeteve private për qëllime zyrtare

7.1 Drejtoria e Administratës së Përgjithshme mund të lejojë përdorimin e automjeteve private për qëllime zyrtare vetëm në rast se në asnjë mënyrë nuk mund të ofrohet vetura zyrtare.

7.2 Drejtoria e Adminsitratës së Përgjithshme është përgjegjëse të mos e inkurajoj përdorimin e veturave private.

7.3 Kompenzimi për përdorimin e automjeteve private bëhet në formë monetare ku për çdo km të kaluar në udhëtim zyrtar paguhet 0.12EUR/km.

7.4 Asnjë dëshmi për kompensim nuk merret parasysht nëse nuk ka paraprakisht vendimin për lejin e përdorimit të veturës private për qëllime zyrtare.

7.5 Komuna nuk merr përgjegjësi në rast dëmi apo aksidenti të veturës private por një gjë e tillë duhet të dakordohet me kompaninë përkatëse të sigurimit.


Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky Rregullore hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës- MAPL si dhe 7 ditë pas publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Mërseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Datë: 07.07.2021 Nr.020-616
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorim të komunave
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Rregullorja e brendshme Nr.02/2021 me numër protokolli 01Nr.02-60/01-16867/21, për përdorimin e automjeteve zyrtare.

I miratuar më datë: 30.06.2021

I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 02.07.2021

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ndërsa sa i përket përmbajtjes është në kompetencë të komunës të zbatoj në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.